



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



## TRYEZË KOMBËTARE mbi QEVERISJEN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Europe House (Pallati Kongreseve), 12 Shkurt 2019, ora 14:00

Tryeza kombëtare mbi Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural synon të sjellë në qendër të debatit publik politikat kombëtare të zhvillimit bujqësor dhe rural në perspektivën e komuniteteve rurale si dhe në dritën e parimeve që udhëheqin procesin e integritimit evropian të vendit tonë. Specifikisht, Tryeza kombëtare do të shërbejë për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm mbi sfidat dhe çështjet e rëndësishme të politikave kombëtare të sektorit si dhe të ndikojë në përmirësimin e tyre.

Përgjatë periudhës tetor-dhjetor 2018, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) ndërmori procesin e konsultimit mbarëkombëtar mbi qeverisjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Takimet konsultuese bënë së bashku anëtarët e forumeve rajonale të Drinit, Arbërit, Egnatias dhe Vjosës. U konsultuan rreth 250 pjesëmarrës, të cilët përfaqësojnë fermerë, organizata të shoqërisë civile, autoritete lokale, duke përfshirë bashkitë dhe këshillat e qarqeve, drejtoritë e bujqësisë, universitetet dhe sipërmarrës në agro-turizëm, bujqësi, bimë medicinale, blegtori, bletari etj. Me inputet e kësaj sipërmarrje konsultuese është përgatitur Letra e Pozicionimit mbi Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Me bindjen se sipërmarrje të tilla janë ndihmë e konsiderueshme për proceset politikë-bërëse, në vazhdimësi të kësaj Tryeze ANRD do të thellojë advokacinë në të gjitha nivelet për të ndikuar sadopak në procesin e formulimit dhe të zbatimit të politikave kombëtare dhe instrumenteve përkatëse.

Duke vlerësuar rëndësinë e sektorit, perspektivën kritike të evidencave të mbledhura, si dhe implikimet e rekomandimeve të propozuara për agjendën aktuale kombëtare rurale, Tryeza mirëpret edhe kontribute nga përfaqësues të lartë të institucioneve qendrore.

Në këtë tryezë janë të ftuar të marrin pjesë organizatat anëtare të ANRD, përfaqësues të shoqërisë civile, shoqata të fermerëve dhe prodhuesve, sipërmarrës ruralë, përfaqësues të autoriteteve vendore dhe qendrore, ekspertë, akademikë e të tjerë persona të interesuar.

*Tryeza Kombëtare mbi Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural organizohet nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural, në kuadër të projektit "Rrjetëzim për zhvillimin rural me pjesëmarrje" mbështetur nga BE dhe zbatuar nga organizatat anëtare të ANRD – Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Agrinet dhe Agro Puka.*





Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



**RRJETËZIM**  
PËR ZHVILLIMIN RURAL  
ME PJESËMARRJE

## PROGRAMI

**Tryezë Kombëtare mbi Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**  
Europe House, 12 Shkurt 2019, ora 14:00

<b>14:00</b>	<i>Regjistrimi i pjesëmarrësve</i>
<b>14:30</b>	Mirëseardhja dhe Fjalët e rastit  <i>Sotirag Hroni – Kryetar Bordi i Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural Përfaqësues i lartë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (TBC)</i> <i>Grigor Gjeci – Drejtor i Programimit dhe Monitorimit të IPARD, Drejtues i Autoritetit Menaxhues, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Përfaqësues i lartë, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (TBC)</i>
<b>15:00</b>	<i>Bujqësia dhe zhvillimi rural dhe politikat kombëtare të sektorit</i>  Qeverisja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – Zëra nga Forumet e Arbërit, Drinit, Egnatias dhe Vjosës - <i>Evelina Azizaj, Koordinatore Kombëtare ANRD</i> <i>Razvan Ghitescu – Menaxher Programi për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Delegacioni i BE-së në Shqipëri</i>  KOMENTUES: <i>Drini Imami - Universiteti Bujqësor i Tiranës</i> <i>Rigerta Loku - Fermere</i> <i>Vitor Malutaj - Ekspert, AgroPuka</i> <i>Saida Hasaj – Nisma “Jemi zëri i fermerëve”, Qarku Shkodër</i>
<b>15:20</b>	<i>Diskutim i hapur</i>
<b>16:30</b>	<i>Përfundime dhe mbyllja</i>



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

